



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE \* MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 46 al. 2 të Ligjit për planifikimin dhe rregulimin e hapsirës ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 2/89), neni 3 të Rregullorës mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000 dhe nenit 19 të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më: 18.07.2003 merr

**V E N D I M**  
**PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E**  
**FSHATIT NDËRKOMBËTAR NË PRISHTINË**

Neni 1

Miratohet vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e "Fshatit Ndërkombëtar" në Prishtinë

Neni 2

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e "Fshatit Ndërkombëtar" në Prishtinë. Lokacioni nga alinea 1.e këtij neni, përfshinë ngastrën kadastrale nr. 494/1, 494/3, Komuna Kadastrale Çagllavicës, sipërfaqja prej 9.51.81 ha, pronë e Komunës.

Neni 3

Lokacioni nga neni 2 i këtij Vendimi jipet në shfrytëzim sipas mënyrës së definuar me kontratë të veçantë në mes shfrytëzuesit dhe Komunës.

Përmbajtja e Kontratës nga alinea 1 e këtij neni, para se të nënshkruhet nga përfaqësuesit e palëve kontraktuese, duhet të prezantohet për shqyrtim dhe miratim në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin Komunal të Prishtinës.

Neni 4

Fillon përgatitja e programit dhe projektit urbanistik për ndërtimin e Fshatit nga neni 1. i këtij Vendimi, që paraqesin bazë për hartimin e Planit detal urbanistik të këtij kompleksi.

Neni 5

Për realizimin e këtij vendimi shpallet tender publik.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Bordi i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë, Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi si dhe Drejtorati për Financa dhe Pronë i Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësia e tyre ,e caktuar për realizimin e këtij vendimi.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**NR. 01.535-1280 DT. 21.07.2003**

**KRYETARI I KUVENDIT**  
**Ismet Beqiri**